

## SHËNIME SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE

### Informacion i përgjithshëm

Njësia ekonomike "Ujësjetllës Kanalizime Korçë" Sh.A është krijuar si Shoqëri Aksionare në datën 17.03.2000, me aktivitet kryesor:

- a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
- b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
- c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
- ç) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- d) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", Statutit të Shoqërisë, VKM Nr. 63 datë 27.1.2016 "Për Riorganizimin e Operatorëve që Ofrojnë Shërbimin e Furnizimit me Ujë të Pijshëm, Grumbullimin, Largimin dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotura"

Njësia ekonomike "Ujësjetllës Kanalizime Korçë" Sh.A është subjekt tatimor dhe kryen veprimtari ekonomike me NUIS: J641031410, vendi i kryerjes së veprimtarisë Bashkia Korçë.

### *Organet e drejtimit të shoqërisë janë:*

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Këshilli i Administrimit

Bashkia Korçë zotëron 100% të aksioneve të Shoqërisë.

Numri mesatar i punonjesve për vitin 2019 është 115 punonjë.

Përsoni përgjegjës për përpunimin e informacionit për hartimin e pasqyrave financiare: Znj. Elia Pendavinji - Drejtore Tregëtare.

Auditues Ligjore:

- **"FILTO- AUDITING" Shpk** me Znj. Tatiana Filto - Audituese Ligjore/Eksperte Kontabel e Regjistruar (Autorizuar) me nr. Liçense 67 datë 31.01.2000;
- **Ilda Ekonomi** Audituese Ligjore/Eksperte Kontabel e Regjistruar (Autorizuar) me nr. Liçense 103 datë 15.10.2008;

Referuar përkufizimit të nenit 3.7 te ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A, përkufizohet si Njësi ekonomike fitimprurëse.

"Ujësjetllës Kanalizime Korçë" Sh.A klasifikohet si *Njësi ekonomike e mesme bazuar në* Nenin 4.1.3. të Ligjit 25/2018 dt.10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" pasi ne datën e

raportimit 31 dhjetor 2019, nuk tejkalon kufijtë e të pakten dy prej 3 kritereve të nenit 4.1.3 për :

- a) Aktivin
- b) Te ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi).
- c) Numrin mesatar te punonjesve per periudhen raportuese 1 Janar-31 Dhjetor 2019.

Pasqyrave Financiare janë hartuar sipas Standardeve Kombëtare te Kontabilitetit SKK te permiresuara Nr.2.

- Parimet bazë për përgatitjen e Pasqyrave Financiare janë ato të përshkruara në SKK 1, paragrafi 40 – 90.
- Parimi i njësisë ekonomike:mban në llogaritë e saj aktivet, detyrimet dhe transaksionet ekonomike të veta;
- Parimi i vijimësisë: veprimtaria ekonomike e njësisë raportuese është e siguruar duke mos pasur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj;
- Kompensimi: Në përputhje me parimin e kompensimit të përshkruar në paragrafët 64 dhe 65 të SKK 1,
- Parimet e përgjithshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, aktivet dhe detyrimet do të kompensohen në pasqyrën e pozicionit financiar, vetëm nëse njësia ekonomike ka të drejtë ligjore t’i kompensojë aktivet dhe detyrimet si dhe ekziston mundësia që ajo ta përdorë këtë të drejtë; Të ardhurat dhe shpenzimet nuk do të kompensohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, me përjashtim të atyre të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga aktivitetet dytësore, apo që kanë ardhur nga një ose disa veprime të ngjashme, apo,që të marra veças nuk janë materiale;
- Kuptueshmëria e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plotë për të qënë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit;
- Materialiteti është vlerësuar nga ana jonë dhe në bazë të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për zëra materiale.

Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare sipas SKK Nr.1 janë:

- Parimi i paraqitjes me besnikeri;
- Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore.
- Parimi i pa-anëshmërisë pa asnjë influencim të qëllimshëm;
- Parimi i maturisë pa optimizem të tepruar, pa nën e mbivlerësim të qëllimshëm;
- Parimi i plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të Pasqyrave Financiare;
- Parimi i qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikat e metodat kontabël;
- Parimi i krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave;

Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj nga data 01.01.2019-31.12.2019.

## **Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKKP).

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuar nga SKKP për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të performancës dhe ardhurave gjithpërfshirëse. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të më poshtme.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019.

Pasqyrat financiare janë paraqitur në gjuhën shqipe dhe në njesinë monetare kombetare Lekë.

## **Krahasueshmëria**

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të njësisë ekonomike dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kombëtar kontabël.

Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor 2019.

## **Qëndrueshmëria e Paraqitjes**

Njësia ekonomike ruan paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën.

## **Njesia ekonomike në vijimësi**

Pasqyrat financiare të njësies ekonomike janë përgatitur mbi supozimin e parimit të vijimësisë, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar mbi 12 muaj.

Më 31 Dhjetor 2019 vlera e aktiveve afatshkurtra është 642.007.947 Lek dhe Vlera e detyrimeve afatshkurtra është 162.257.360 Lekë duke treguar se njësia ekonomike me aktivet e saj mund të shlyejë detyrimet afatshkurtra.

Aksioneri, ortaku i vetëm i njesise ekonomike dhe përfituesi i kapitalit aksioner të shoqërisë shpreh gatishmërinë që shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Korçë” Sh.A të plotësojë detyrimet financiare në çdo kohë dhe t’i sigurojë asaj gjithë mbështetjen që mund të nevojitet për të mbajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit në nivele të tilla që të përmbushin shlyerjen e detyrimeve në përputhje me parimin e vijimësisë të përshtatshëm për aktivitetin që kryen njesia ekonomike.

## **Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

## **Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Njësia ekonomike ka kryer transaksione në monedhën vëndase Lek dhe në monedhen e huaj Euro. Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën kryesore të përdorur në konvertimin e gjendjeve të bilancit emërtuar në monedhe të huaj në datën e hartimit të Pasqyrave Financiare është si më poshtë (në LEKË):

<b>Kursi zyrtar</b>				
Periudha kohore	31.12.2019 - 31.12.2019			
Monedha e zgjedhur	Euro (EUR)			
<b>Data</b>	<b>Lekë për njësi të monedhës së huaj</b>			
31.12.2019	121.77			

## Politikat kontabile

### Instrumentat financiare

Instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar për një njësi ekonomike, si dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali për një njësi ekonomike tjetër.

Instrumentat financiarë të shoqërisë përbëhen nga: mjetet monetare; një instrument borxhi (si llogari, hua e arkëtueshme ose e pagueshme) që plotësojnë kushtet në paragrafin 7 të SKKP nr.3.; një zotim për të marrë një hua e cila: (i) nuk mund të paguhet në para, dhe (ii) kur zotimi realizohet, pritet që ai të plotësojë kushtet e dhëna në paragrafin 7 SKKP nr.3.

### Njohja fillestare

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit në fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të Instrumentave financiar kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë Instrumentin financiar. Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe, për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

### Vlerësimi i mëpasshëm

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë.

### Paraja dhe mjetet monetare ekuivalente me to

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë llogari rrjedhëse dhe depozitat në para në bankat e nivelit të dytë. Në total Njësia ekonomike ka një aktiv monetar prej 288.347.515 lekësh në datën 31.12.2019

Nr	Emri i Bankes	Monedha	Nr llogarise	Vlera ne valute	Kursi fund vit	Vlera ne leke
1	BKT	ALL	406 000 458	2,017,455.67		2,017,456
2	BKT	ALL	406 000 666	1,518,643.57		1,518,644
3	BKT	ALL	406 000 666/1	126,509.88		126,510
4	Raiffesisen Bank	ALL	20060143	957,912.21		957,912
5	Raiffesisen Bank	ALL	050 000 0644	69,059.92		69,060
6	Pro Credit Bank	ALL	50 006762 00 01	1,267,014.38		1,267,014
7	Pro Credit Bank	ALL	51 006762 01 01	2,114,323.98		2,114,324
8	Intesa SanPaolo Bank	ALL	72400731102	1,778,851.51		1,778,852
9	Intesa SanPaolo Bank	ALL	72400731101	516,653.95		516,654
10	Credins Bank	ALL	49496	692,696.28		692,696
11	Credins Bank 1	ALL	1058694	2,375,840.01		2,375,840
12	Credins Bank 1	ALL	1058690	5,032,944.42		5,032,944
13	Credins Bank	ALL	449671	168,000,000.00		168,000,000
14	Credins Bank	ALL	169333	10,330,948.02		10,330,948
15	Credins Bank	ALL	51287	15,042,412.88		15,042,413
16	Credins Bank	EURO	67616	29,289.64	121.77	3,566,599
17	Credins Bank WEC	EURO		42,602.05	121.77	5,187,652
18	Credins Bank SSW	EURO		28,411.63	121.77	3,459,684
19	Union Bank	ALL	41 01 12 71 00 30 214	3,303,142.09		3,303,142
20	Union Bank	ALL	42 01 12 71 05 10 118	5,151,323.07		5,151,323
21	Union Bank	ALL	41 01 12 71 00 30 112	5,431,032.76		5,431,033
22	Alpha Bank	ALL	902 012 123 000 300 587	2,760,264.32		2,760,264
23	ABI	ALL	207 113 10 000 02 7	529,231.44		529,231
24	ISPB	ALL		42,000,000.00		42,000,000
25	Tirana Bank	ALL	5.00383E+11	2,778,137.77		2,778,138
26	OTP	ALL	1265632	2,339,181.38		2,339,181
27	Arka	ALL		0		0
<b>Totali</b>						<b>288,347,515</b>

### Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Vlerësimi i shumave të pambledhshme bazohet në gjykimin e drejtimit.

Njësia ekonomike ka llogari të arkëtueshme ne datën 31.12.2019 me vlerë 236.968.275 lekë ku përfshihen faturat e konsumit të ujit për klientet në zonën e juridiksionit, debitorët faturat e të cilëve nuk janë arkëtuar.

Kjo klasë rishikohet çdo vit dhe krijohet provizion sipas SKK 6 .

Në mbeshtetje të Ligjit Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi Të ArdhuratI Ndryshuar”, si edhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara, SKK 6 Provizionet, Detyrimet Dhe Aktivitet E Kushtëzuara,

Shoqëria krijoi dhe miratimoi provizion nga Këshilli i Administrimit vlerën prej 4.138.500 lekë për klasën "Të drejta të arkëtueshme"- Nga aktiviteti i shfrytëzimit i emërtuar në llogaritë e kontabilitetit si Llogaria 411.

Provizionit është bërë konform Standardeteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara, SKK 6 *Provizionet, Detyrimet Dhe Aktivitet E Kushtëzuara dhe më konkretisht,*

*Provizioni është një detyrim aktual, për të cilin koha e shlyerjes ose shuma janë të pasigurta. Fusha e zbatimit të Provizionit janë të gjitha detyrimet dhe të ardhurat SKK 8 . që kanë kohën e shlyerjes dhe shumën të pasigurta).*

*Gjithashtu për klientët të cilët nuk kanë paguar faturat dhe janë çuar në proces gjyqësor për të shlyer detyrimet në total me vlerë 11,761,146 lekë janë zbritur nga llogari Të drejta të arkëtueshme.*

#### **A - NJOHJA E PROVIZIONEVE**

*Njësia ekonomike do ta njohë provizionin si një detyrim në pasqyrën e pozicionit financiar dhe shumën e tij si një shpenzim, përveç rastit kur një SKK tjetër kërkon që kostoja të njihet si pjesë e kostos së një aktivi si p.sh. inventar ose tokë, ndërtesa, makineri dhe pajisje.*

*Njësia ekonomike do ta njohë një provizion vetëm kur e ashtuquajtura ngjarje detyruese ka ndodhur para datës së raportimit.*

*Krijimi i një provizioni të ri, ose rritja e një provizioni ekzistues, zakonisht regjistrohet si një shpenzim i periudhës kontabël.*

*Përsa s'qaruar më sipër kushtet mbi të cilat një e drejtë e arkëtueshme me probabilitet për të mos u arkëtuar mund të kalojë në provizion, UKKO për të pasqyruar një situatë të qartë sipas SKK1 , ka kryer një analizë të detajuar të të drejtave të arkëtueshme duke filluar që nga viti 2008 , kur u falën të gjitha detyrimet dhe kamatvonesat.*

#### **Të tjera të arkëtueshme**

- a) Shteti debitor për tatim fitimin për vitin 2019 me vlerë 3,184,038 lekë
- b) Shteti- TVSH për tu marrë 3,507,406Lekë

#### **Te drejta të arkëtueshme nga proceset gjyqësore**

- a) Përfshihen kliente të cilët janë debitorë ndaj Shoqërisë, të cilët janë në proces përmbarimor për arkëtim me vlerë totale 11,761,146 lekë.

#### **Inventarët**

Inventaret regjistrohen në kontabilitet me koston e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e inventarit në vendin e përcaktuar. Për përcaktimin e kostos së inventarëve është zgjedhur metoda hyrje e parë dalje e parë. Në fund të periudhës shoqëria ka ngritur një komision mbi vlerësimin e inventarit sipas SKK Nr. 4. Vlerësimi i inventarit është akoma në proces.

Vlera e inventarit në datën 31.12.2019 është 98.239.567 lekë. (Inventarët analitike bashkangjitur)

**AKTIVE TOTALE AFATSHKURTRA**

**642.007.947 LEKË.**

### **Aktivitet afatgjata**

Aktive financiare përfshijnë tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit, tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupi, tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata letrat me vlerë (aksionet, bono të thesarit, obligacione, zotërimet në fonde investimesh, etj) që nuk ka gjasa të shiten brenda 12 muajve të ardhshëm të paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

### **Tituj të tjerë të huadhënies (të drejta të arkëtueshme) 127.831.488 lekë**

Zëri kryesor i kësaj klase përbëhet 123,711,350 lekë në bazë të Marrëveshjes ndërmjet Ujësjellës Kanalizime Korçë dhe Bashkisë Korçë është nënshkruar një Marrëveshje “Mbështetjen financiare për Sh.A Ujësjellës Kanalizime Korçë nga Bashkia Korçë” në datën 04.02.2010 me Nr Prot 45 ku Palët Bashkia Korçë merr angazhim të mbështesë UKKO për një periudhë 16 vjeçare në total 1.390.000 Euro.

Gjithashtu pjesëmarrja në dy projekte me vlerë të arketimeve afatgjata 984.645 leke, si edhe 1,630,305 lekë interesa pasive dhe pagesa të kryera ndaj përbaruesve me vlerë 1,505,188 lekë.

### **Aktivitet Afatgjate Materiale (AAM) dhe Jomateriale (AAJM)**

Njohja dhe Matja Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM-ve që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrat financiare është vlerësuar me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e aktiveve në vendin dhe kushtet ekzistuese (SKK 5).

Njohja mëpashme: AAM-të paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi (SKK 5).

Nëse një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet koston së elementit, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet edhe nëse ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kosto fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabël aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të koston aktuale të kësaj pjese minus amortizimin e vlerësuar.

Amortizimi: Për llogaritjen e amortizimit të AAM-ve njësia ekonomike ka përdorur metodën e amortizimit mbi bazën e vleftës së mbetur të AAM-ve. Normat e amortizimit të përdorur janë ne perputhje me normat e percaktuara ne ligjin 8438 date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”.

Para aplikimit normat janë miratuar nga Aksionari i Njesisë sipas Vendimit Nr 2 datë 13.02.2020, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	EMERTIMI I AKTIVEVE AFATGJATA	Norma e amortizimit 2020	Norma e amortizimit 2020
		UJESJELLES	KANALIZIME
1	Ndërtesat	5%	
2	Ndërtime dhe instalime te pergjithshme/ Impianti Fotovoltaik	5%	
3	Instalime specifike dhe komplekse	1.0%	1.0%
4	Matesat elektronik/mekanik	8%	
5	Makineri dhe paisje pune	20%	
6	Mjete transporti	20%	
7	Mobilje orendi	20%	
8	Mjete kompjuterike	25%	
9	Aktive Afatgjata jo materiale	15%	

### Aktivët Afatgjata Materiale

Në bilanc AAM përfshijne Toka dhe ndërtesa, impiante dhe makineri,të tjera Instalime dhe pajisje që paraqiten me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm si dhe parapagime për aktive materiale dhe në proces që paraqiten me vlera nominale e shumës së parapaguar.

Tokat dhe Investimet në proces nuk amortizohen. Ç`regjistrimi: Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç`regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale percaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit.

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Shoqëria vlerëson në datën raportimi nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

### Toka dhe ndërtesa

Vlera fillestare 2019					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2019			31/12/2019
1	Toka	13,214,592			13,214,592
2	Ndertesat	952,259,555	1,425,415		953,684,970
	<b>TOTALI</b>	<b>965,474,147</b>	<b>1,425,415</b>	<b>-</b>	<b>966,899,562</b>
Amortizimi 2019					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2019			31/12/2019
1	Toka				-
2	Ndertesat	248,124,638	35,206,746		283,331,384
	<b>TOTALI</b>	<b>248,124,638</b>	<b>35,206,746</b>	<b>-</b>	<b>283,331,384</b>
Vlera Kontabel Neto 2019					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2019			31/12/2019
1	Toka	13,214,592	-	0	13,214,592
2	Ndertesat	704,134,917	1,425,415	35,206,746	670,353,586
	<b>TOTALI</b>	<b>717,349,509</b>	<b>1,425,415</b>	<b>35,206,746</b>	<b>683,568,178</b>



## Instalime dhe Impiante

Vlera fillestare 2019					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2019			31/12/2019
1	Ndërtime dhe instalime të përgjithshme + IMPIANTE	1,111,411,637			1,111,411,637
2	Instalime teknike specifike dhe komplekse	6,456,287,192	370,963,036		6,827,250,228
<b>TOTALI</b>		<b>7,567,698,829</b>	<b>370,963,036</b>	<b>0</b>	<b>7,938,661,865</b>
Amortizimi 2019					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2019			31/12/2019
1	Ndërtime dhe instalime të përgjithshme + IMPIANTE	282,987,700	41,421,197		324,408,897
2	Instalime teknike specifike dhe komplekse	1,136,014,033	56,068,146		1,192,082,178
<b>TOTALI</b>		<b>1,419,001,733</b>	<b>97,489,343</b>	<b>-</b>	<b>1,516,491,075</b>
Vlera Kontabel Neto 2019					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2019			31/12/2019
1	Ndërtime dhe instalime të përgjithshme + IMPIANTE	828,423,937	0	41,421,197	787,002,740
2	Instalime teknike specifike dhe komplekse	5,320,273,159	370,963,036	56,068,146	5,635,168,049
<b>TOTALI</b>		<b>6,148,697,096</b>	<b>370,963,036</b>	<b>97,489,343</b>	<b>6,422,170,789</b>

## Të tjera Instalime dhe pajisje

Vlera fillestare 2019					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2019			31/12/2019
1	Makineri e paisje	97,311,063	2,406,398		99,717,461
2	Matesa individuale uji	372,467,389	1,238,186		373,705,575
3	Mjete Transporti	96,416,575	3895000		100,311,575
4	Mobilje, orendi	18,890,955	52080		18,943,035
5	Paisje Zyre , informatike	130,998,160	597,865		131,596,025
<b>TOTALI</b>		<b>716,084,142</b>	<b>8,189,529</b>	<b>0</b>	<b>724,273,671</b>
Amortizimi 2019					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2019			31/12/2019
1	Makineri e paisje	67,476,592	6,345,984		73,822,575
2	Matesa individuale uji	49,040,117	25,931,214		74,971,331
3	Mjete Transporti	68,457,904	5,721,568		74,179,471
4	Mobilje, orendi	14,443,994	893,732		15,337,726
5	Paisje Zyre , informatike	91,430,521	9,970,240		101,400,761
<b>TOTALI</b>		<b>290,849,127</b>	<b>48,862,737</b>	<b>0</b>	<b>339,711,865</b>
Vlera Kontabel Neto 2019					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2019			31/12/2019
1	Makineri e paisje	29,834,471	2,406,398	6,345,984	25,894,886
2	Matesa individuale uji	323,427,272	1,238,186	25,931,214	298,734,244
3	Mjete Transporti	27,958,671	3,895,000	5,721,568	26,132,104
4	Mobilje, orendi	4,446,961	52,080	893,732	3,605,309
5	Paisje Zyre , informatike	39,567,639	597,865	9,970,240	30,195,264
<b>TOTALI</b>		<b>425,235,015</b>	<b>8,189,529</b>	<b>48,862,737</b>	<b>384,561,806</b>

**Aktivitet Afatgjata Jo-materiale (AAJM-t)**

Aktivitet afatgjata jomateriale përfshijnë liçensat, të drejtat për përdorim dhe emri i mire.

*Njohja dhe Matja:* Liçensat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

*Shpenzime te Mëpasshme:* Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.

*Amortizimi:* Amortizimi njihet në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatesinë e parashikuar (SKK 5) të aktiveve të trupëzuara që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

Njësia ekonomike ka aplikuar normë amortizimi prej 15% mbi vlerën fillestare.

Vlera e AJM në datën e raportimi të PF është 37.920.155 lekë.

*Zhvlerësimi (Rënia në vlerë):* Shoqëria e vlerëson në datën e raportimit nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

Në fund të periudhës shoqëria nuk ka aplikuar vlerësim sipas SKK.Nr.5

Vlera fillestare 2019					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2019			31/12/2019
1	Aktive Afatgjata Jomateriale	316,856,921	724,358	272,936,361	44,644,918
	<b>TOTALI</b>	<b>316,856,921</b>	<b>724,358</b>	<b>272,936,361</b>	<b>44,644,918</b>
Amortizimi 2019					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2019			31/12/2019
1	Aktive Afatgjata Jomateriale	260,775,591	6,630,014	260,680,841	6,724,763
	<b>TOTALI</b>				
Vlera Kontabel Neto 2019					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		01/01/2019			31/12/2019
1	Aktive Afatgjata Jomateriale	43,825,811	724,358	6,630,014	37,920,156
	<b>TOTALI</b>	<b>43,825,811</b>	<b>724,358</b>	<b>6,630,014</b>	<b>37,920,156</b>

<b>Vlera fillestare 2019</b>					
<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Gjendje</b>	<b>Shtesa</b>	<b>Pakesime</b>	<b>Gjendje</b>
		<b>01/01/2019</b>			<b>31/12/2019</b>
1	Toka	13,214,592	0	0	13,214,592
2	Ndertesa	952,259,555	1,425,415	0	953,684,970
3	Ndërtime dhe instalime të përgjithshme + IMPIANTE	1,111,411,637	0	0	1,111,411,637
4	Instalime teknike specifike dhe komplekse	6,456,287,192	370,963,036	0	6,827,250,228
5	Makineri e paisje	97,311,063	2,406,398	0	99,717,461
6	Matesa individuale uji	372,467,389	1,238,186	0	373,705,575
7	Mjete Transporti	96,416,575	3,895,000	0	100,311,575
8	Mobilje, orendi	18,890,955	52,080	0	18,943,035
9	Paisje Zyre , informatike	130,998,160	597,865	0	131,596,025
10	Aktive Afatgjata Jomateriale	316,856,921	724,358	279,661,124	37,920,155
	<b>TOTALI</b>	<b>9,566,114,039</b>	<b>381,302,338</b>	<b>279,661,124</b>	<b>9,667,755,253</b>
		<b>9,566,114,039</b>	<b>381,302,338</b>	<b>279,661,124</b>	<b>9,667,755,253</b>
<b>Amortizimi 2019</b>					
<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Gjendje</b>	<b>Shtesa</b>	<b>Pakesime</b>	<b>Gjendje</b>
		<b>01/01/2019</b>			<b>31/12/2019</b>
1	Toka	0	0	0	
2	Ndertesa	248,124,638	35,206,746	0	283,331,384
3	Ndërtime dhe instalime të përgjithshme + IMPIANTE	282,987,700	41,421,197	0	324,408,897
4	Instalime teknike specifike dhe komplekse	1,136,014,033	56,068,146	0	1,192,082,178
5	Makineri e paisje	67,476,592	6,345,984	0	73,822,575
6	Matesa individuale uji	49,040,117	25,931,214	0	74,971,331
7	Mjete Transporti	68,457,904	5,721,568	0	74,179,471
8	Mobilje, orendi	14,443,994	893,732	0	15,337,726
9	Paisje Zyre , informatike	91,430,521	9,970,240	0	101,400,761
10	Aktive Afatgjata Jomateriale	260,775,591	6,630,014	260,680,841	6,724,763
	<b>TOTALI</b>	<b>2,218,751,089</b>	<b>188,188,840</b>	<b>260,680,841</b>	<b>2,146,259,087</b>
		<b>2,218,751,088</b>	<b>188,188,840</b>	<b>260,680,841</b>	<b>2,146,259,087</b>
<b>Vlera Kontabel Neto 2019</b>					
<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Gjendje</b>	<b>Shtesa</b>	<b>Pakesime</b>	<b>Gjendje</b>
		<b>01/01/2019</b>			<b>31/12/2019</b>
1	Toka	13,214,592	-	-	13,214,592
2	Ndertesa	704,134,917	<b>1,425,415</b>	<b>35,206,746</b>	670,353,586
3	Ndërtime dhe instalime të përgjithshme + IMPIANTE	828,423,937	-	<b>41,421,197</b>	787,002,740
4	Instalime teknike specifike dhe komplekse	5,320,273,159	<b>370,963,036</b>	<b>56,068,146</b>	5,635,168,049
5	Makineri e paisje	29,834,471	<b>2,406,398</b>	<b>6,345,984</b>	25,894,886
6	Matesa individuale uji	323,427,272	<b>1,238,186</b>	<b>25,931,214</b>	298,734,244
7	Mjete Transporti	27,958,671	<b>3,895,000</b>	<b>5,721,568</b>	26,132,104
8	Mobilje, orendi	4,446,961	<b>52,080</b>	<b>893,732</b>	3,605,309
9	Paisje Zyre , informatike	39,567,639	<b>597,865</b>	<b>9,970,240</b>	30,195,264
10	Aktive Afatgjata Jomateriale	43,825,811	<b>724,358</b>	<b>6,630,014</b>	37,920,156
	<b>TOTALI</b>	<b>7,335,107,431</b>	<b>381,302,338</b>	<b>188,188,840</b>	<b>7,528,220,929</b>

## **DETYRIMET DHE KAPITALI**

### **Llogaritë e pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar.

### **Detyrime Afatshkurtra**

**162.257.360 Lekë lekë**

Detyrimet afatshkurtra: Një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur: (a) ajo pret ta shlyejë detyrimin brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) ajo e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) detyrimi do të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose (d) njësia ekonomike nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të evituar shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit

### **Arkëtime në avancë për porosi**

**297.035 lekë**

Përbëjnë fatura të paguara dy herë nga klientët dhe që UKKO do ti sistemojë në vijëmesi.

### **Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit**

**5.226.976 lekë.**

Këtu përfshihen detyrime afatshkurtra që UKKO ka për palët e treta, Furnitorë për shërbime 1,509,432.49, Energji elektrike dhe ujë 3,717,544 lekë.

### **Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore 251,597 lekë.**

Përbëjnë detyrimet afatshkurtra që UKKO ka ndaj stafit që është pjesë e projektit SAVESAFEWATER të financuar nga Bashkimi Europian. Sipas kushteve të projektit këto detyrime do të shlyhen nga UKKO dhe më pas do të rimbursohen në vlerën 85%.

### **Të pagueshme për detyrimet tatimore**

**2,641,954.79lekë**

Përbëjnë detyrimet afatshkurtra të cilat përbëjnë detyrimet e muajit Dhjetor 2019 të cilat paguhen në Janar 2020 – Sigurime shoqërore Shëndetësore 2.086.055lekë, Tatimi mbi të ardhurat 549.270 lekë, Tatim në burim 6630 lekë.

### **Të tjera të pagueshme**

**3,728,314.00 lekë**

Përfshihen taksat e Bashkisë që qytetarët paguajnë në fatyrën e ujit. Këto vlera arkëtohen nga UKKO nëpërmjet arketimit të faturave dhe më pas depozitohen në degën e Të Ardhuave të Bashkisë.

### **Të ardhura të shtyra**

**150.111.487 lekë**

Përbëhen nga Shpenzime të interesave të papaguara të kredive 149,479,093 lekë. Sistemimi I granteve/ sistemim dalja e materialeve nga magazina 632,394 lekë.

## **Huadhënie dhe huamarrje**

**Huate e Dhëna:** Huate e arketueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa të përcaktuara sipas kushteve kontraktuale me pagesa fikse dhe variabël në varësi të normave të interesit të cilat nuk janë të kuotuar.

Pas matjes fillestare, të tilla aktive financiare maten në vazhdim me kosto të amortizuara.

Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

**Huate e marra:** Huatë (detyrime financiare), janë njohur fillimisht me vlerën e tregut plus kostot e transaksioneve dhe me pas njihen me koston e amortizuar.

Shpenzimet e interesit të llogaritur me normën e interesit efektive (NEI) i cili pasqyrohet në rezultat llogariten me vlerën e drejtë dhe pasqyrohen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Kostot e huamarrjes që lidhen drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve kualifikuese, të cilat janë aktive që kërkojnë domosdoshmërisht një periudhë të madhe kohe për t'u bërë gati për përdorimin e tyre përfundimtar ose për shitje mund të shtohen në koston e këtyre aktiveve deri në momentin që këto aktive janë kryesisht gati për t'u përdorur ose shitur.

## **Zhvlerësime të aktiveve financiare**

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo më shumë ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efektë negative në flukset e ardhshme të parasë që parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, propabiliteti që debitori do të falimentojë apo një riorganizim financiar, dhe pamundësia apo shkeljet në pagesa konsiderohen si tregues që një llogari e arkëtueshme është e zhvlerësuar.

Në fund të periudhës shoqëria nuk ka aplikuar vlerësim sipas SKK.Nr.3

***Detyrime ndaj institucioneve të kredisë*** ***5,066,306,070 lekë***

Përfshihen të gjitha detyrimet ndaj institucioneve Financiare për kreditë e marra nga UKKO.

Që prej vitit 2007 UKKO ka nisur të shlyejë kreditë sipas Amortizimeve përkatëse.

**Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit 162,432,411 lekë.**

Përfshihen detyrimet nga Furnitorëve FMO SHPK dhe Ludwing Pfeiffer Hoch- Und Tiefbau.

Fmo Shpk sipas Kontratës së Financimit dhe intaslimit të Impiantit fotovoltaik për prodhimin e energjisë elektrike me një vlerë të mbetur prej 52,433,975 lekë.

Ludwing Pfeiffer Hoch- Und Tiefbau për një pjesë të mbetur të projektit Korça me një detyrim për të shlyer sipas Kontabilizimit të Vendimit të Gjykatës "ICC INTERNATIONAL COURT OF ARBITRATION " Nr 20379/GFG/FS (C20380 GFG and 20381/GFG) 24.01.2017 . Si edhe i marrëveshjes me Nr. 199 Prot date 31.05.2019 midis UKKO dhe Ludwing Pfeiffer Hoch- Und Tiefbau si edhe Kontabilizimit të vlerës së TVSH-së faturave 38 date 09.12.2014 dhe 52 date

30.09.2015. Ludwig Pfeiffer " Rehabilitim I Rrugeve" . Në total vlera e detyrimit 109,998,436 lekë.

**Të ardhura të shtyra afatgjata 2,522,044,478 lekë**

Përshihen Grante afatgjata me vlerë 2,522,044,478 lekë, që i takojnë granteve që ukko ka përfituar gjatë investimeve të kryera në rrjetin Ujësjetllës dhe Kanalizime. Vlera është në vlerë neto duhe zbritur amortizimet vjetore të asete.

## **KAPITALI**

**Kapitali i Nënshkruar 370,708,000 Lekë**

Kapitali i Nënshkruarparaqitet me Vlerën kontabël e kapitalit aksionar të emetuar

**Rezerva rivlerësimi 6,407,302 lekë**

**Rezerva ligjore 4.667.073 lekë**

**Rezerva statutore 27,122,404 lekë**

**Fitimi i periudhës neto 756.658 lekë**

## **TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET**

### **Njohja e të ardhurave**

*Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit.*

*Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.*

*Një njësi ekonomike duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.*

*Kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e një shërbimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese (nganjëherë referuar si metoda e përqindjes së përfundimit).*

**Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit 359.136.301 lekë**

Përfshihen të ardhurat nga Faturimi i ujit të pijshëm, Ujit të nodotur, Tarifës së Shërbimit si edhe pikat e reja të lidhjeve.

**Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar 8.637.638 lekë**

Janë shuma e materialeve të dala nga magazina të përdorura në investime duke shtuar Asetet.

**Të ardhura të tjera të shfrytëzimit** **67.610.450 lekë**

Përbëhen nga të ardhurat nga investimet e Granteve dhe të ardhura të tjera.

**Të ardhurat financiare**

Të ardhurat financiare përmbledhin të ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv

**Interesa të arkëtueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)** **14.632.432 lekë**

Përfshihen të ardhurat nga intereasat dhe kamatvonesat

**Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit** **9.413.233 lekë**

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimi nga ndryshimi i kursit të këmbimit në dt 31.12.2019

**SHPENZIMET**

Shpenzimet janë flukse dalëse (pakësimet e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese që rezultojnë në pakësimin e aktiveve apo rritjen e detyrimeve dhe që zvogëlojnë kapitalin e njësisë ekonomike, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me shpërndarjet te pjesëmarrësit e kapitalit. Njohja e shpenzimeve rezulton direkt nga njohja dhe matja e aktiveve dhe detyrimeve. Një njësi ekonomike duhet të njohë shpenzimet në pasqyrën e performancës financiare kur lind një ulje në përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhet me një pakësim të një aktivi ose rritje të një detyrimi, e cila mund të matet me besueshmëri. Shpenzimet per kerkime e zhvillime pergjithesisht jane ngarjuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin.

**Lënda e parë** **21,277,987 lekë**

Përbën shumën e materialeve të dala nga magazina gjatë periudhës për kryerjen e Shpenzimeve dhe Mirëmbajtjes.

**Materiale të konsumueshme** **32,978,706 lekë**

Vlera e shpenzimeve të energjisë elektrike dhe ujit.

**Shpenzime të personelit** **99,716,724 lekë**

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e

shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

**Leje vjetore e paguar** Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të çmuara lidhur me lejen vjetore për tu paguar në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

• Shpenzime paga	81,440,052.95lekë
• Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore	14,469,405 lekë
• Shpenzime të tjera personeli	6,515,346.67lekë
• Shpenzime konsumi dhe amortizimi	200,444,359 lekë
• Shpenzime të tjera shfrytëzimi	40.985.452 lekë
• Shërbime nga të tretë	24,885,084lekë
• Tatime,Taksa, tarifa kontraktuale, Sigurime, etj	3,689,121 lekë
• Shpenzime të tjera	12,411,247 lekë

### Shpenzime interesi

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

**Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme** **61,249,245.14lekë**

**Fitimi/humbja para tatimit** **1,411,800 lekë**

### Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi apo humbjet e vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit të Pasqyrave Financiare, si edhe çdo lloj rregullimi kontabel të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 dhe 2018 paraqiten më poshtë:

	<u>31.12.2019</u>	<u>31.12.2018</u>
Tatim Fitimi	15%	15%
<b>Tatimi fitimi</b>		<b>655,142 lekë</b>
<b>Fitimi neto</b>		<b>756,658 Lekë</b>

### PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE (Metoda direkte)

Pasqyrat fluksi monetar është hartuar sipas SKK 2 .Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare tregon hyrjet dhe daljet e mjeteve monetare në një njësi ekonomike gjatë periudhës kontabël. 62. Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare jep informacion në lidhje me ndryshimet në mjetet monetare dhe



ekuivalentët e mjeteve monetare të një njësie ekonomike për një periudhë raportuese, duke treguar veças ndryshimet e aktiviteteve të shfrytëzimit, aktivitetet investuese dhe ato të financimit.

Krahasuar me vitin paraardhës kemi një rënie të mjete monetare me 36.564.509 lekë.

Pasqyra e fluksit moentar është hartuar sipas Metodës direkte.

### **PASQYRA E NDYSHIMEVE TË KAPITALIT - PERIUDHA 1 JANAR - 31 DHJETOR 2019**

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto është hartuar sipas SKK 2 dhe paraqet fitimin e një njësie ekonomike ose humbjen për një periudhë të raportimit, zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në pasqyrën e performancës për periudhën, efektet e ndryshimeve në politikat kontabël dhe korigjimet e gabimeve të njohura në periudhën dhe shumat e investimeve, dividendët dhe shpërndarjet e tjera ndaj investorëve të kapitalit neto gjatë periudhës.

Kapitali I njesise ekonomike me vlere totale 370.708.000 leke eshte ne zoterim 100% të Bashkisë Korçë.

Nr i pjesëve të kapitalit është 370.708 me vlerë nominale të një pjese 1 000 lekë.

#### **Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara**

##### ***Çështje gjyqësore***

Më 31 Dhjetor 2019 Shoqëria/subjekti nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur

1. Çështja civile me nr. 447, në Gjykatën e Apelit Korçë.

Objekti : Ankimi i Vendimit Nr. 791, datë 02.07.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për çështjen me objekt: "Pavlefshmëri absolute e kontratës me nr. klienti 660278 në emër të paditësit Kujtim Merolli. Rregullimin e pasojave të kësaj pavlefshmërie. Përrjashtimin e paditësit nga detyrimi që prodhon kontrata me nr. klienti 660278."

Palët: Ankues: Paditësi Kujtim Merolli, i Paditur : UKKO Sh.A.

2. Çështja civile me nr. 356, në Gjykatën e Apelit Korçë.

Objekti : Ankimi i Vendimit Nr. 429, datë 12.04.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për çështjen me objekt: " Anullimi i Vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Këshillit të Rrethit Korçë Nr. 30 datë 24.04.1998 për sipërfaqen e tubacionit të kanalizimeve që përdorej për interes publik."

Palët: Ankues: Të paditurit Sali Shushka etj

3. Çështja civile me nr. 502, në Gjykatën e Apelit Korçë.

Objekti: Ankimi i Vendimit Nr. 1276, datë 05.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për çështjen me objekt: "Detyrimin e palës së paditur për dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës "

Palët: Ankues: Paditësi Ilo Vangjel, i Paditur : UKKO Sh.A.

Ilo Vangjel e ka ankimuar Vendimin , në Gjykatën e Apelit Korçë dhe çështja është regjistruar me nr. 502 dhe është në pritje për gjykim në Apel.) kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkoje rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

***Detyrime tatimore***

Librat e Shoqërisë/subjektit janë audituar nga organet tatimore për periudhën 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore mund të konsiderohen përfundimtare.

**Ngjarje pas datës se bilancit**

Me 31 Dhjetor 2019 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.

**Hartuesi i Pasqyrave Financiare**

Elia Pendavinji

(Drejtoresha Drejtoria Tregëtare)

Për Drejtimin e Njesisë Ekonomike

Petrit Tare

(Drejtor i Përgjithshëm)

